



KRYETARI I KRYEQYTETIT

14-020/05-197529/23, më 26. 09. 2023

Në bazë të dispozitave të nenit 13 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), të nenit 5, paragrafi 5.2 të Ligjit për ndërmarrjet publike 03/L - 087 ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr. 31/15, qershor 2008), të nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kryetari i Kryeqytetit, merr këtë

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E ANËTARES NË KOMISIONIN KOMUNAL TË AKSIONARËVE PËR
NDËRMARRJEN PUBLIKE LOKALE "PALLATI I RINISË" SH.A.

1. Mimoza Sylejmani, caktohet anëtare në komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale të Komunës së Prishtinës "Pallati i Rinisë" SH.A.
2. Anëtari i cekur në pikën 1 të këtij vendimi, së bashku me dy anëtarët të cilët i emëron Kuvendi i Komunës, e përbëjnë komisionin komunal të aksionarëve për ndërmarrjen publike lokale "Pallati i Rinisë" SH.A.
3. Anëtarja e komisionit komunal të aksionarëve, e caktuar me këtë vendim, ka të drejtë të veprojë në emër të Kryetarit të Kryeqytetit.
4. Veprimet e anëtares të komisionit komunal të aksionarëve duhet të jenë në përputhje me Ligjin për ndërmarrjet publike, Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndërmarrjet publike dhe Ligjit për shoqëritë tregtare.
5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. 14-020/04-166032/23 i dt. 11.08.2023.
6. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

I DORËZOHET:

- Anëtares;
- Qendrës për shërbim me qytetarë;
- Në dosje.

KRYETARI I KRYEQYTETIT

Përparim Rama

